



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 29 gusht, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese hodhi poshtë një kërkesë referuese të Pjetër Shalës, duke e konstatuar atë të papranueshme. Z. Shala ishte ankuar se i ishin shkelur të drejtat themelore nga vendimet e Trupit Gjykses dhe të Panelit të Gjykatës së Apelit që të lejohet pranimi i deklaratës së tij dhënë policisë belge në 2016. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese konstatoi se është kompetencë e Gjykatës Themelore dhe e Dhomës së Apelit të marrin vendime mbi pranueshmërinë e provave, ndërsa detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vendosë nëse procesi në tërësi dhe mënyra se si u mor prova, ishin të drejta. Duke qenë se procesi i gjykimit dhe apelet e mëtejme nuk kanë përfunduar ende, gjykatësit konstatuan se kërkesa referuese ishte e parakohshme.

Gjatë konferencës përgatitore të Mbrojtjes në çështjen gjyqësore *Shala*, që u mbajt më 25 dhe 25 gusht, Trupi Gjykses dha një numër udhëzimesh dhe urdhrash gojorë për organizimin e paraqitjes së provave nga Mbrojtja.

Trupi Gjykses njoftoi se, në varësi të rezultatit të vendimit të vet mbi mocionin e Mbrojtjes për pushimin e një pjese të çështjes kundër tij, paraqitja e provave nga Mbrojtja do të fillojë gjatë javës së 18 shtatorit. Data e saktë do të bëhet e ditur më vonë.

Trupi Gjykses i caktoi Mbrojtjes 40,5 orë për paraqitjen e provave të saj dhe ZPS-së i caktoi të njëjtën sasi kohe që do të përdorë faktikisht Mbrojtja për të marrë në pyetje secilin dëshmitar të Mbrojtjes. Mbrojtësi i Viktimave do të ketë 25% të kohës së përdorur faktikisht nga Mbrojtja.

Për garantimin e efikasitetit të procesit dhe për të shmangur dëgjimin e dëshmimeve të dëshmitarëve që nuk janë relevante për përcaktimin e së vërtetës ose që janë përsëritëse, Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen të heqë pesë emra nga lista e dëshmitarëve dhe të dorëzojë listën e rishikuar të dëshmitarëve deri më 29 gusht 2023.

Në të njëjtën çështje, më 21 korrik Trupi Gjykses lëshoi Vendimin mbi kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për pranim në prova të raporteve nga tre dëshmitarë ekspertë. Vendimi u bë publik këtë javë. Megjithëse Mbrojtësi i Viktimave kishte menduar t'i paraqiste provat e dhëna nga ekspertët vetëm me shkrim, Mbrojtja kërkoi që dëshmitarët të paraqiteshin në gjykatë, sepse synonte t'i merrte në pyetje. Trupi Gjykses vendosi që dy prej ekspertëve, Karin Duhne-Prinsen dhe Çajen Lozano Parra, nga Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor i Holandës, të dëshmonin në sallën e gjyqit, sepse dëshmia e tyre lidhej me të vërtetën e akuzave kundër z. Shala si edhe me zhdëmtime të mundshme, dhe rrjedhimisht Mbrojtja duhet të kishte mundësinë t'i merrte në pyetje. Dy dëshmitarët dëshmuan në sallën e gjyqit më 21 gusht.





Dëshmitari i tretë, Stefan Lerc, është ekspert për llogaritjen e humbjeve në të ardhura dhe dha dëshmi lidhur me dëmin material që pretendohet se pësuan të gjitha viktimat pjesëmarrëse në proces. Meqë kjo dëshmi ka lidhje vetëm me zhdëmtimet dhe për arsye se Rregullorja e Procedurës dhe e Provave përcakton se aspektet që kanë të bëjnë me zhdëmtimet duhet të trajtohen kryesisht në formë të shkruar, Trupi Gjykses vendosi të pranonte vetëm raportin me shkrim të këtij dëshmitari, ndërsa Mbrojtjes iu lejua që të parashtronte pyetje ose kundërshtime me shkrim ndaj raportit.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënë, 18 shtator, duke filluar në orën 9:30 paradite.

Në gjykimin e *Thaçit dhe të tjerëve*, dëshmitarët e 18-të dhe 19-të të thirrur nga Prokuroria dëshmuan këtë javë me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private. Sipas përmbledhjes së shkurtër të lexuar në sallën e gjyqit nga Prokuroria, dëshmia e dëshmitarit të 19-të ishte në lidhje me ndalimin dhe zhdukjen e pretenduar e anëtarit të familjes së dëshmitarit në Drenoc.

Më 16 gusht Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me kontaktin me një dëshmitar të caktuar. Mbrojtja e Thaçit kërkoi që të shfuqizohet protokollin që rregullon kontaktet me dëshmitarët në lidhje me këtë dëshmitar, bazuar në njoftimin e Prokurorisë se ka vendosur të mos e thërrasë këtë dëshmitar në këtë fazë të procesit.

Trupi Gjykses konstatoi se protokollin vazhdon të jetë në fuqi, sepse Prokuroria ende ka ndër mend ta thërrasë dëshmitarin, por në një fazë të mëvonshme të procesit. Trupi Gjykses sqaroi gjithashtu se sa herë që Prokuroria të vendosë të mos e thërrasë një dëshmitar për të cilin ka njoftuar më parë, ajo duhet ta informojë Mbrojtjen, sepse në këto raste protokollin pushon së qeni në fuqi. Rrjedhimisht, Prokuroria duhet që ta rishikojë në mënyrë proaktive dhe të vazhdueshme listën e dëshmitarëve të saj dhe të njoftojë pa vonesë Mbrojtjen sa herë të vendosë të mos e thërrasë një dëshmitar të caktuar.

Seanca e radhës në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënë, 4 shtator, duke filluar në orën 9:00 paradite.

Pyetje nga gazetarët Nuk pati pyetje

